



UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

ZYRA PËR SIGURIMIN E CILËSISË

PLANI I PUNËS 2020

Mitrovicë, 2020



Përmbajtja

Hyrje	2
Misioni	2
Vizioni	2
Vlerat mbi të cilat mbështetet veprimtaria e UMIB-it, janë:	2
Cilësia në UMIB	3
Parimet dhe vlerat mbi të cilat bazohet cilësia në UMIB	3
Sigurimi i brendshëm i cilësisë	3
Organet e UMIB të cilat merren me sigurimin e cilësisë	4
Komisioni qendror për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit (KQSCV).....	4
Zyra për Sigurimin e Cilësisë (ZSC)	4
Kordinatori për cilësi i njësisë akademike.....	5
Procesi i brendshëm i sigurimit të cilësisë	6
Objektivat dhe veprimet	6
Procesi i përmirësimit	8
Përfundim	8
Plani i punës	9



Hyrje

Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 06. 03. 2013 ka themeluar Universitetin Publik të Mitrovicës, kurse Kuvendi i Kosovës me datën 31 maj 2013 ka ratifikuar vendimin. Në bazë të Statutit të Përkohshëm, miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në kuadër të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini"(UMIB) funksionojë gjashtë fakultete: Fakulteti i Gjeoshkencave (FGJT), Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore (FTU), Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK), Fakulteti Juridik (FJ), Fakulteti Ekonomik (FE) dhe Fakulteti i Edukimit (FE).

Misioni

Misioni i UMIB-it është që të ofrojë mësimdhënie cilësore për përgatitjen e kuadrove në fusha unike për Kosovën, rajonin e më gjerë, i dedikuar të zhvillojë kërkime shkencore, projekte profesionale, këshillime profesionale duke qenë në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes të mirëqenies dhe avancimit shoqëror.

Vizioni

Vizioni i UMIB-it është të jetë Institucion i Arsimit të Lartë lider në rajon, në edukim dhe hulumtim shkencor, për përgatitjen e kuadrove konkurrentë në fusha unike për Kosovën dhe rajonin, për të përmbushur kërkesat e së tashmes dhe projektuar nevojat e së ardhmes, për nevojat shkencore – akademike, të ekonomisë së tregut, institucioneve e diplomacisë, i fokusuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien sociale.

Vlerat mbi të cilat mbështetet veprimtaria e UMIB-it, janë:

- Përgjegjësi dhe Respektim i ndërsjellë;
- Drejtësi dhe Ndershmëri;
- Integritet dhe Llogaridhënie;
- Diversitet dhe mirëqenie;
- Kreativitet dhe Liri Intelektuale;
- Kujdesi ndaj mjedisit dhe shoqërisë.



Cilësia në UMIB

UMIB, procesin e sigurimit të cilësisë e bazon në Statutin e tij, Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Rregulloren për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin, Udhëzuesin për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin; Paketën e instrumenteve për matjen e cilësisë; Treguesit Kryesorë të Performanës dhe Udhëzimet që dalin nga AKA. Poashtu, UMIB, merr si referencë kyqe edhe KKK-në, udhëzime të parapara të ENQA-së, si dhe procesin e Bolonjës.

Parimet dhe vlerat mbi të cilat bazohet cilësia në UMIB

Sigurimi i cilësisë në UMIB bazohet në parimet dhe vlerat si:

- Përgjegjësia;
- Transparenca;
- Llogaridhënia;
- Integriteti akademik;
- Përmirësimi i vazhdueshëm;
- Gjithëpërfshirja.

Cilësisë në UMIB matet nga mekanizmat e jashtëm dhe ata të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Cilësia e jashtme në UMIB matet gjatë proceseve të akreditimit nga ekspert të jashtëm të përcaktuar nga AKA-ja, ndërsa cilësia e brendshme matet me mekanizmat dhe instrumentet e përcaktuara nga UMIB.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Universiteti i Mitrovices Isa Boletini ka një sërë mekanizmash dhe instrumentesh që luajnë rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e cilësisë.

Në UMIB sigurimi i brendshëm i cilësisë bëhet nga disa mekanizma dhe përfshinë një gamë të gjerë akterësh.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UMIB përfshinë:

- Studentët;



- Stafin akademik;
- Stafin administrativ;
- Biznesin dhe akterët tjerë nga tregu i punës;
- Menaxhmentin, dhe,
- Të diplomuarit e UMIB.

Organet e UMIB të cilat merren me sigurimin e cilësisë

Në UMIB, organet kryesore të cilat menaxhojnë me procesin e sigurimit të cilësisë janë:

- Komisioni qendror për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit (KQSCV);
- Zyra për sigurimin e cilësisë (ZSC);
- Koordinatorët për cilësi në njësitë akademike.

Komisioni qendror për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit (KQSCV)

KQSCV-ja është organi kryesor në UMIB i cili merret me procesin e sigurimit të cilësisë. Ky komision është organ këshilldhënës i Senatit të UMIB për çështjet që kanë të bëjnë me cilësinë. Anëtarët e KQSCV-së propozohen nga Rektori dhe miratohen në Senatin e UMIB për një mandat 4 vjeçar. Pas përfundimit të këtij mandati, së paku 1/3 e anëtarëve të KQSCV-së duhet të vazhdojnë të jenë pjesë e tij me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë në punën e Komisionit.

Zyra për Sigurimin e Cilësisë (ZSC)

Zyra për sigurimin e cilësisë e UMIB është zyrë e pavarur e cila drejtëpërdrejtë i raporton vetëm Rektorit të UMIB. Kjo zyrë, angazhohet në ngritjen e cilësisë në UMIB duke zbatuar të gjithë politikën institucionale. Zyra përbëhet nga zyrtarë për cilësi, të rekrutuar përmes konkursit publik. Zyrtarët e cilësisë në ZSC nuk janë pjesë e stafit akademik të UMIB. Zyra kujdeset për matjen e cilësisë, përmes të gjitha instrumenteve të paketës së instrumenteve në UMIB. Zyra harton raporte me gjetje dhe rekomandime për çdo pyetësor të zhvilluar, dhe atë e dërgon tek Rektori i UMIB. Poashtu, zyra të dhënat nga pyetësorët i dërgon tek Dekani i njësisë akademike me qëllim të planifikimit për zhvillim të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.



Zyra ka për mision që të sigurojë nivel cilësor të mësimdhënies, mësimnxënies, programeve studimore, hulumtimit dhe administrimit të UMIB përmes implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe të sigurojë që mekanizmat dhe procedurat për arritjen e cilësisë të jenë funksionale. Përbushja e këtij misioni është në harmoni me misionin e institucionit dhe i shërben përbushjes së vizionit të tij për të qenë universiteti më i mirë publik në vend dhe rajon, dhe për të përgatitur kuadro të cilat do të kontribuojnë zhvillimit të komunitetit lokal dhe global, në fusha specifike të studimit.

Koordinatori për cilësi i njësisë akademike

Koordinatorin për cilësi të njësisë akademike e emëron Dekani i njësisë dhe ai i përgjigjet drejtëpërdrejtë vetëm atij. Koordinatori për cilësi në nivel të njësive akademike: Ofron udhëzime për stafin akademik dhe studentët lidhur me aspektet praktike dhe akademike të zbatimit të ECTS-së; Udhëzon departamentin përkatës dhe komisionin e studimeve të njësisë akademike gjatë procesit të akreditimit/riakreditimit për të hartuar/rishikuar programet e studimit; Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike, përkujdeset dhe monitoron përfshirjen e të gjitha palëve me interes (stafi akademik, studentët, Alumnit, bizneset apo anëtarët e Bordit Këshillëdhënës) për hartimin/rishikimin e programeve të studimit; Mbështet në procesin e vlerësimit të lëndëve dhe mësimdhënësve, procesin e vetë-vlerësimit të stafit akademik, procesin e vlerësimit të stafit administrativ, takimet e këshillave të fakulteteve, takimet e rregullta të stafit akademik me qëllim diskutimin për çështjet me interes në mësimdhënie, mësimnxënie apo kërkim, Organizon sesione informuese për stafin akademik dhe studentët lidhur me procesin e Bolonjës; Në bashkëpunim me menaxhmentin e njësisë akademike sistemon të dhëna dhe informata lidhur me aktivitetin shkencor/artistik në njësinë akademike (evidentimi i punimeve shkencore, performanca artistike, projektet profesionale dhe shkencore); Në bashkëpunim me zyrtarin për bashkëpunim ndërkombëtar, këshillon menaxhmentin dhe studentët e njësisë akademike lidhur me realizimin e mobilitetit të studentëve - "Learning Agreement" (në përputhje me vendimin e njësisë akademike, shpjegon procedurat akademike të njohjes së kredive, marrëveshjen, transkriptin e shënimeve, monitorimin para dhe pas realizimit të mobilitetit, etj.)



Procesi i brendshëm i sigurimit të cilësisë

Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UMIB përfshinë:

- Studentët;
- Stafin akademik;
- Stafin administrativ;
- Biznesin dhe akterët tjerë nga tregu i punës;
- Menaxhmentin, dhe,
- Të diplomuarit e UMIB.

Politikën e Sigurimit të brendshëm të cilësisë e përcakton KQSCV-ja, dhe zbatohet nga ajo si dhe ZSC-ja.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë bazohet në:

- Planifikim;
- Matje;
- Menaxhim;
- Realizim, dhe,
- Përmirësim.

Të gjitha këto bëhen të mundura vetëm pasi të jetë mbledhur i gjithë informacioni i nevojshëm. Procesin e mbledhjes së informacionit e udhëheq KQSCV-ja. Informacioni mbildhet nga këto instrumenta (Të harmonizohet me paketën e instrumentave):

Objektivat dhe veprimet

Në vijim janë paraqitur objektivat dhe veprimet specifike të planifikuara për vitin 2020, me qëllim të arritjes së synimit të përgjithshëm - përmirësimin e cilësisë në UMIB.

Objektiva 1: Plotësim-ndryshimi dhe kompletimi i infrastrukturës ligjore dhe teknike për funksionimin e zyrës për cilësi.



UNIVERSITETI I MITROVICËS / UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +383 (0)28 535 725 / 535 727

Veprimet:

- Angazhimi për Plotësim - Ndryshimi i rregullores për cilësi,
- Angazhimi për Plotësim - Ndryshimi i udhëzuesit për cilësi
- Angazhimi për Draftimin e rregullorës për funksionimin e zyrën e cilësisë
- Angazhimi për aprovimin e ndryshimeve të paketës së instrumenteve për matjen e cilësisë

Objektiva 2: Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë në UMIB.

Veprimet:

- Vlerësimi nga studentët
- Vlerësimi nga parlamentit studentor dhe këshilleve të studentëve në njësitë akademike
- Vlerësimi nga organizatat studentore
- Vlerësimi nga stafi akademik
- Vetëvlerësimi i stafit akademik
- Vlerësimi nga menaxhmenti
- Vlerësimi nga administrata
- Vlerësimi nga ALUMNI
- Vlerësimi nga Bizneset
- Vlerësimi i Dekanëve për stafin akademik

Objektiva 3: Ngritja e cilësisë në UMIB.

Veprimet:

- Organizimi i trajnimeve për stafin akademik
- Organizimi i trajnimeve për stafin administrativ
- Realizimi i punëtorive të ndryshme



Objektiva 4: Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare për cilësi

Veprimet:

- Përgatitja për anëtarësim në Asociacionin e Universiteteve Europiane - EUA
- Përgatitja për anëtarësim në Unionin e Studentëve Europian
- Bashkëpunimi me organizata vendore dhe ndërkombëtare që merren me cilësi në arsimin e lartë

Procesi i përmirësimit

Pas hartimit të raporteve, UMIB dhe njësitë akademike, bëjnë përmirësimin e fushave për të cilat vlerësimi ka rezultuar të jetë më i dobët.

Ky vlerësim përfshinë:

Përpilimi i planit të përmirësimit në bazë të raportit final

Analizimi i syllabuseve

Propozimi i ndryshimeve për syllabuset

Propozimi për trajnimet e personelit

Komunikimi i rekomandimeve dhe mbledhja e komenteve nga personeli

Përgatitja e planit të veprimit përfundimtar për përmirësim.

Përfundim

Për UMIB, komponenta e menaxhimit të cilësisë është pikë e fortë dhe kryesore për zhvillimin e institucionit: mësimdhënies, mësimnxënies, hulumtimit, shërbimit në komunitet, dhe vet përmbushjes së misionit dhe vizionit të tij. Një strukturë mirë e definuar të akterëve që merren me sigurimin e cilësisë në UMIB, si dhe një procedurë e qartë për zhvillimin e aktiviteteve drejtë sigurimit të kësaj komponente, e bëjnë institucionin të jetë serioz dhe i vendosur drejtë të ardhmes të sigurtë në Arsimin e Lartë.



UNIVERSITETI I MITROVICËS / UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; Tel: +383 (0)28 535 725 / 535 727

Plani i punës				
Nr.	Detyrat - Aktivitetet	Qëllimet	Akterët e përfshirë	Afatet kohore
1.	Vlerësimi nga studentët	Vlerësojnë stafin akademik, lëndët infrastrukturën në UMIB	ZSC	Janar 2020 Qershor 2020
		Vlerësojnë shërbimet administrative dhe menaxheriale në UMIB	Studentët	Qershor 2020
		Vlerësojnë programin akademik (në vitin e fundit të studimeve)		Korrik 2020
2.	Vlerësimi nga stafi akademik	Vlerëson proceset e zhvilluara në UMIB (Kushtet dhe shërbimet e ofruara)	ZSC Stafi akademik	Qershor 2020
3.	Vetëvlerësimi i stafit akademik	Për të parë vlerësimin që profesorët dhe asistetët kanë për performancën e tyre.	ZSC	Janar 2020
			Stafi akademik	Qershor 2020



UNIVERSITETI I MITROVICËS / UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; Tel: +383 (0)28 535 725 / 535 727

4.	Vlerësimi nga menaxhmenti	Për të matur performancën e tyre, të stafit akademik si dhe për tu njohur me nevojat që paraqiten gjatë punës së tyre.	ZSC Menaxhmenti qendror dhe në njësitë akademike	Korrik 2020
5.	Vlerësimi nga administrata	Përshtypjet për performancën e tyre, si dhe për tu njohur me nevojat që paraqiten në punën e tyre.	ZSC Administrata	Nëntor 2020
6.	Vlerësimi nga ALUMNI	Për të matur faktin se studimet e tyre a kanë qenë në përputhje me vendin e tyre të punës, dhe për të marrur sygjërimet për ndryshimet në programet e studimit dhe iniciimin e programeve të reja.	ZSC Alumni Shoqata Alumni	Shtator 2020
7.	Vlerësimi nga Bizneset	Për të parë nevojat e biznesit dhe komunitetit, për t'i mundësuar UMIB-it ofrimin e programeve të reja në përputhje me tregun e punës, si dhe ri-shikimin e programeve ekzistuese.	ZSC Bizneset	Shtator 2020



UNIVERSITETI I MITROVICËS / UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; Tel: +383 (0)28 535 725 / 535 727

8.	Vlerësimi i Dekanëve për stafin akademik	Për të matur performancën e stafit akademik, nga prizmi i dekanëve.	ZSC Dekanët e njëjësive Stafi akademik	Korrik 2020
9.	Trajnimi i stafit akademik dhe administrativ	Metodat dhe teknikat e reja të shërbimeve dhe mësimdhënies online.	Rektorati ZSC Stafi akademik	Proces i vazhdueshëm
10.	Kontakti me institucione ndërkombëtare për cilësi dhe aplikimi për anëtarësim	Inkurajimi i vazhdueshëm për përmirësim të cilësisë në UMIB	Rektorati ZSC	Proces i vazhdueshëm
11.	Aprovimi i ndryshimeve të paketës së instrumenteve për matjen e cilësisë	Plotësësimi i paketës së instrumenteve me instrumente të reja dhe ndryshimi i instrumenteve ekzistuese me qëllim të nxjerrjes së të gjeturave konkrete për nevojat e brendshme të zhvillimit të cilësisë.	KSCV ZSC	Proces i vazhdueshëm



UNIVERSITETI I MITROVICËS / UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; Tel: +383 (0)28 535 725 / 535 727

12.	Trajnime për ECTS me stafin adimnistrativ	Rëndësia e ECTS-ve	ZSC KSCV	Nëntor 2020
13.	Trajnime për ECTS me studentët	Rëndësia e ECTS-ve	ZSC KSCV	Nëntor 2020
14.	Takime të rregullta me koordinatorët e njësive akademike	Kordinimi i aktiviteteve mujore	ZSC Kordinatorët e njësive akademike	Çdo muaj
15.	Takime të rregullta me menaxhmetin	Kordinimi i aktiviteteve të zyrës për cilësi me menaxhmetin e Universitetit	ZSC Prorektoria për Mësimdhënie, Çështje të Studentëve dhe Zhvillim të Cilësisë	Në vazhdimësi
16.			Menaxhmenti	



UNIVERSITETI I MITROVICËS / UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; Tel: +383 (0)28 535 725 / 535 727

	Përgatitjet për riakreditim në njësitë akademike	Akreditimi i programeve në njësitë akademike	KSCV Kordinatori për zhvillim akademik ZSC Njësitë akademike Studentët	Maj 2020 Dhjetor 2020
17.	Dita e orientimit	Orientimi i studentëve të rinjë në kampusin universitar (Universiteti, Programet, Cilësia, Përfshirja, Aktivitetet etj)	Rektorati ZSC Njësitë akademike Studentët	1 Tetor
18.	Dita e Universitetit të Mitrovicës	Aktivitete për shënimin e ditës së themelimit të universitetit	Rektorati ZSC Njësitë akademike	6 Mars



UNIVERSITETI I MITROVICËS / UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; Tel: +383 (0)28 535 725 / 535 727

			Studentët	
19.	Dita e Studentëve	Në kordinim me studentët do të organizohen aktivitete për këtë ditë (Mesazhe dhe aktivitete për fuqinë dhe rëndësinë e studentëve në zhvillimin e vendit tonë)	Rektoriati ZSC Njësitë akademike Studentët	17 Nëntor
20.	Dita Ndërkombëtare e Librit	Aktivitete me studentët (Dhuro një libër, shkëmbe dije)	Rektorati ZSC Njësitë akademike Studentët	23 Prill
21.	Dita Ndërkombëtare e Arsimit	Aktivitete për shënimin e kësaj dite (Konferencë: Roli i universitetit të Mitrovicës në përgatitjen e kuadrove të reja në vend)	Rektorati ZSC Njësitë akademike Studentët	24 Janar



UNIVERSITETI I MITROVICËS / UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës

<http://www.umib.net>; Tel: +383 (0)28 535 725 / 535 727

22.	Java Ndërkombëtare e Bibilotekës	Aktivitete në kordinim me studentët (Botimi i revistes studentore)	Rektorati ZSC Njësitë akademike Studentët	19-25 Prill
23.	Dita Ndërkombëtare e Hulumtimit	Aktivitete që lidhen me nxitjen e hulumtimit shkencor.	Rektorati ZSC Njësitë akademike Studentët	2 Maj